

20-21
Faza 2

E drejta civile

TEZA 4

I. Shënoni me V shprehjet e vërteta dhe me X ato që janë të gabuara

- ____ 1. Veprimi juridik që kufizon zotësinë juridike të një personi fizik, është i pavlefshëm.
- ____ 2. Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë apo i mëvonshëm i veprimit të personit.
- ____ 3. Pala kontraktuese mund të heqë dorë nga kontrata, brenda shtatë ditëve nga përfundimi i saj, pa treguar arsytet.
- ____ 4. Personat juridikë nuk janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga organet e tyre gjatë përmbushjes së detyrave.
- ____ 5. Objekti i detyrimit është gjithmonë një veprim.
- ____ 6. Pala porositëse që dëshiron të pajtojë dy agjentë për rrethin e Tiranës mund ta bëjë këtë vetëm nëse përcakton në mënyrë të saktë se në cilën pjesë të territorit do të veprojë secili.
- ____ 7. Padia për kërkimin e pavlefshmërisë së testamentit ose disponimit me testament ngrihet nga çdo person i interesuar brenda tre vjetëve nga çelja e trashgimisë.
- ____ 8. Nëse kreditori nuk paguhet tërësisht nga sendi i lënë peng ose hipotekë, ka të drejtë që pjesën e kredisë së papaguar ta nxjerrë nga çdo pasuri tjetër e debitorit.
- ____ 9. Bashkëpronari ka të drejtë të tjetërsojë ose disponojë në çdo mënyrë tjetër pjesën e tij në sendin e përbashkët të paluajtshëm.
- ____ 10. Testamenti bëhet vetëm në formë noteriale. (10 pikë)

II. Plotësoni fjalitë dhe jepni sqarimet e mëposhtme:

- a. Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga _____

- b. Roli i ndërmjetësit në kontratën e ndërmjetësimit është _____

- c. Trashgimtari i paaftë për punë nënkupton _____



E drejta civile

d. Personi që ka poseduar qetësisht e pa ndërprerje, duke u sjellë sikur të ishte pronar për njëzetë vjet në një pronë të paluajtshme, bëhet pronar i saj. Ky është definicioni i _____
(10 pikë=2+3+2+3 pikë)

V. Jepni shpjegimet e mëposhtme:

a. Cilat janë kriteret që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e dëmit jopasuror?

b. Qëllimi i shoqatës duhet të plotësojë këto kriteret?

c. Cilat janë llojet e veprimit juridik me kusht?

d. Cfarë është kushti penal?

(10 pikë=3+3+3+1 pikë)



PROCEDURË CIVILE

TEZA 18

1. Përcaktoni nëse pohimi i mëposhtëm është i vërtetë (V) apo i gabuar (X)

- a. Nuk mund të ngrihet padi kundër një personi që i mungon zotësia për të vepruar. ()
- b. Kur trup gjykues tërhiqet për të marrë vendim, në dhomën e këshillimit duhet të jenë prezent vetëm gjyqtarët dhe sekretari i seancës. ()
- c. Kur Gjykata e Lartë vendos prishjen e vendimit të formës së prerë, pas shqyrtimit të kërkesës për rishikimin e tij, ajo vazhdon vetë gjykimin e themelit. ()
- d. Rregullat mbi kompetencën tokësore të përmbauesit gjyqësor janë të zbatueshme edhe për përmbauesin privat ()

8 pikë

2. Rrumbullakosni përgjigjen e saktë:

Gjykata e shkallës së parë gjykon:

- a) Me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, çështjet me objekt shpalljen e vdekjes së një personi;
- b) Me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, çështjet që kanë për objekt padi me vlerë nën 20 milion lekë;
- c) Në çdo rast, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

4 pikë


3. Padia mund të ngrihet:

- a) _____
- b) _____
- c) _____

6 pikë

4. Krahasoni pezullimin e gjykimit nga pushimi i gjykimit.

10 pikë



Handwritten notes on lined paper, including a faint circular stamp in the upper right corner.

3. Rastet e uljes së dënimit nën kufjtë e parashikuar nga ligji. (10 pikë)


Handwritten notes on lined paper, including a faint diagram of a scale of justice in the background.

Blank lined writing area at the top of the page.

4. Plagosja e rëndë me dashje dhe dallimet nga vepra penale e 'Vrasjes me dashje' të mbetur në tentative (10 pikë)

Blank lined writing area for the answer, containing a faint watermark of a scale of justice.

5. Efektet e përsëritjes në kryerjen e veprës penale. (10 pikë)



A series of horizontal lines for writing, with a faint watermark of a scale of justice visible in the center of the page.

TEZA 20
PROCEDURË PENALE



I. Shënoni me V ose G, përkatësisht përgjigjen e vërtetë ose të gabuar (çdo përgjigje e saktë - 1 pikë; gjithsej – 5 pikë):

1. ___ Dyshimet për akuzën çmohen në favor të të pandehurit.
2. ___ Faktet në procesin penal mund të provohen edhe me prova që ligji nuk i parashikon.
3. ___ Gjykata e Lartë njëson praktikën gjyqësore me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.
4. ___ Urdhri për ndalimin e të dyshuarit nxirret nga policia gjyqësore.
5. ___ Në rastet e ekstradimit vendimi gjyqësor merr formë të prerë pas gjykimit në Gjykatën e Lartë.

II. Vendosni shenjën “+” ose “x” tek alternativa e saktë (çdo përgjigje e saktë - 2 pikë; gjithsej – 10 pikë):

1. Lidhur me procedurën e marrjes të kampionëve biologjikë është i vërtetë pohimi:

- marrja e kampionëve biologjikë nga i pandehuri mund të kryhet, në çdo rast, edhe pa pëlqimin e tij;*
- kampioni nuk mund të merret pa pëlqimin e tij, të dhënë qoftë edhe me gojë;*
- mund të merren me detyrim, por vetëm pasi të jetë dhënë miratimi nga gjykata;*
- prania e mbrojtësit gjatë procedurës varet nga vullneti i të pandehurit;*
- prokurori nuk ka të drejtë të urdhërojë shoqërimin e personit, të cilit do t'i merret kampioni biologjik, përveç rastit kur personi është i pandehuri.*

2. Lidhur me sendet e gjetura gjatë kontrollit, **nuk** është i vërtetë pohimi:

- sekuestrohen, me kusht që të jenë përcaktuar në vendimin që lejon kontrollin;*
- sekuestrohen, edhe pse nuk janë përcaktuar në vendimin që lejon kontrollin, por lidhen me veprën penale objekt hetimi;*
- sekuestrohen, edhe pse nuk janë përcaktuar në vendimin që lejon kontrollin, me kusht që mbrojtësi i personit nën hetim të jetë i pranishëm;*
- sekuestrohen, edhe pse nuk janë përcaktuar në vendimin që lejon kontrollin, me kusht që të lidhen me një veprë penale që ndiqet kryesisht.*

3. Lidhur me urdhrin penal të dënimit është i vërtetë pohimi:

- gjykata nuk ka të drejtë të ndryshojë dënimin e caktuar nga prokurori;*
- urdhri penal duhet të ngarkojë të dënuarin me pagimin e shpenzimeve të procedimit;*
- gjykata në çdo rast duhet të vendosë, pa i kthyer aktet prokurorit;*
- vendimi për miratimin e urdhrin penal kundërshtohet në gjykatën e apelit;*
- urdhri penal i dënimit është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës.*

4. Marrëveshja për kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit, e lidhur me kushtin për pranimin e pjesshëm të akuzave, është:

- relativisht e pavlefshme;*
- nul;*
- e papranushme;*
- e papërdorshme;*
- absolutisht e pavlefshme.*



5. Gjykata e Lartë **nuk** ka të drejtë të vendosë:

- prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes;*
- prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim;*
- lënien në fuqi të vendimit;*
- prishjen e vendimit dhe deklarimin e pafajshëm të të pandehurit;*
- prishjen e vendimit të apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.*

III. Pyetje konceptuale (2 pyetje, 10 pikë)

1. Cili është disponimi i gjyqtarit të seancës paraprake kur në ngarkim të të pandehurit del një fakt i ri penal, që nuk është përmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq? (5 pikë)

2. Cilat janë garancitë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, kur ai merret në pyetje nga policia gjyqësore? (5 pikë)

TEZA 5
E DREJTË EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

I. Shënoni përkatësisht me V ose X sipas rastit përgjigjen e vërtetë ose të gabuar. (çdo pyetje vlerësohet me 2 pikë)

1. Gjykata Europiane e Drejtësisë ushtron pushtetin gjyqësor në BE. _____
2. Gjykata Europiane e Drejtësisë ka kompetencën për t'u shprehur në rrugë paragjykimore mbi interpretimin dhe vlefshmërinë e akteve dytësore. _____
3. Gjykata Europiane e Drejtësisë shqyrton rekurset në lidhje me mospërbushjet e detyrimeve të shteteve anëtare. _____
4. Gjykata Europiane e Drejtësisë shqyrton kontrollin mbi legjitimitetin e akteve komunitare. _____
5. Gjykata Europiane e Drejtësisë ushtron edhe pushtetin ekzekutiv në BE. _____

II. Rrumbullakos përgjigjen e saktë (çdo pyetje vlerësohet me 2 pikë)

1. Është karakteristikë e protektoratit :
 - a) Pushtimi i shtetit të dobët nga shteti i fuqishëm
 - b) Kontrolli i politikës së jashtme të shtetit të dobët nga shteti i fuqishëm
 - c) Qeverisja e shtetit më të dobët nga shteti më i fuqishëm
2. Neutraliteti i Shqipërisë:
 - a) ishte neutralitet i njohur por jo i garantuar
 - b) ishte neutralitet i njohur por jo i armatosur
 - c) ishte neutralitet i njohur dhe i garantuar
3. Renoncimi :
 - a) është humbja e shtetësisë me vullnetin e vetë personit
 - b) është fitimi automatik i një shtetësie të re në rastet kur bëhen ndryshime territoriale
 - c) është humbja e shtetësisë së parë kur fiton një shtetësi të re në rastet kur bëhen ndryshime territoriale
4. Zona është :
 - a) fundi i detit të hapur
 - b) zona që shtrihet pas ujërave territoriale deri në 200 milje
 - c) zona që shtrihet 12 milje pas ujërave territoriale
5. Kur një traktat ka konflikt me një normë *jus cogens*:
 - a) traktati nuk mund të regjistrohet në OKB
 - b) traktati ka efekt vetëm midis palëve
 - c) traktati humbet vlefshmërinë



TEZA 5
E DREJTË EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

III. Jepni konceptin e saktë (çdo pyetje vlerësohet me 5 pikë)

1. Liria e qarkullimit të kapitaleve.

2. Bashkëpunimi Rajonal si element thelbësor i Procesit të Stabilizim- Asociimit.



**TEZA 5
E DREJTË EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE PUBLIKE**

IV. Bëni krahasimin e koncepteve të mëposhtme. (çdo pyetje vlerësohet me 5 pikë)

1. Krahasoni teoritë kryesore të integritimit europian.

2. Krahasoni Rekomandimet dhe Opinionet si akte jo të detyrueshme që veprojnë në BE.



2- Është i mbështetur në ligj vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për B-në dhe C-në? (15 pikë)

3- Vlerësoni vendimin e gjykatës për ndarjen e çështjes në ngarkim të A-së dhe B-së dhe pezullimin e saj. (10 pikë)



KAZUS 3

E DREJTA PRIVATE & PROCEDURE CIVILE

I. Faktet

1. Me vendimin Nr. 45, datë 30.05.1994, K.K.K.Pr. Delvinë, paditëses F.Q. i është njohur pronësia $S=982m^2$ truall dhe nga kjo i është kthyer $613m^2$ dhe kompesuar pjesa tjetër.
2. Me V.K.K.Pr., Nr. 175, datë 19.05.1995, (Delvinë) i njëjti Komision ka disponuar mbi pronat e trashëgimlënësit të Personit të Tretë A.B., duke i njohur $2940 m^2$ truall dhe kthyer $1520 m^2$ dhe kompesuar $1420m^2$ truall.
3. Komisioni nuk i ka kthyer sipërfaqen $60 m^2$ truall, duke thënë se është zënë me ndërtime. Personi i tretë ka paraqitur padi në gjykatë duke kundërshtuar këtë vendim të K.K.K.Pronave, por pa u thirrur në këtë gjykim paditësja F.Q.
4. Me vendimin nr. 325, datë 14.06.1996, Gjykata e Rrethit Delvinë ka vendosur të ndryshojë vendimin 175, datë 19.05.1995, duke vendosur kthimin e banesës $60 m^2$ personit të tretë. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe është lëshuar urdhri ekzekutiv nr. 1794, datë 18.06.2012.
5. Përmbartuesi privat ka kërkuar ndaj paditësit të lirojë e dorëzojë vullnetarisht banesën.
6. Pas marrjes së këtij njoftimi të përmbartimit paditësja F.Q. ka ngritur padinë me objekt: "Pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, vendimit të Gjykatës së Rrethit Delvinë Nr. 325, datë 14.06.1996."
7. Pretendimet e paditësit janë:
 - K.K.K.Pr. është shprehur më parë në favor të paditësave për këtë pronë dhe ky komision s'mund të shprehej përsëri edhe në favor të personit të tretë.
 - Disponimi i dytë i këtij komisioni është i pavlefshëm, sepse ai kthen vetëm pronën që është në pronësi të shtetit dhe jo pronën, që tashmë ka kaluar në favor të personit fizik privat.
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Delvinë duhej të konstatonte se kjo pronë mbivendosej me atë të paditëses F.Q.
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur :« Rrëzimin e kërkesë padisë, heqjen e masës së pezullimit të titullit ekzekutiv. »
- Arsyetimi i vendimi të mësipërm të gjykatës është si më poshtë:**
8. Titulli ekzekutiv, që goditet për pavlefshmëri bazuar në nr. 609 të K.Pr.C. është vendimi gjyqësor nr. 325, datë 14.06.1996, i Gjykatës së Rrethit Delvinë.
9. Ky titull, "... bazuar në nr. 609/2 të K.Pr.C. mund të kundërshtohet vetëm për fakte të ndodhura pas dhënies së këtij vendimi... »
10. Përderisa faktet për të cilat kërkohet të kundërshtohet ky titull ekzekutiv (vendim gjyqësor) kanë ngjarë ose kanë ekzistuar para dhënies së këtij vendimi (titulli), prandaj ky pretendim nuk mund të pranohet.
11. Paditësat duhet të kundërshtonin vendimin Nr. 175, datë 19.05.1995 i plotësuar me vendimin Nr. 325, datë 14.06.1996, për të zgjidhur të drejtën e pronësisë për banesën $60 m^2$.
12. Vendimi Nr. 325, datë 14.06.1996, i Gjykatës vërtetë ka njohur e kthyer edhe $S=60m^2$ në favor të personave të tretë dhe në këtë kuptim nuk përmban ndonjë detyrim mbi paditësen, por gjithsesi ai



përmban një detyrim të caktuar, pavarësisht se nuk ka të përcaktuar personin e detyruar, por paditësat e posedojnë këtë banesë në një kohë kur pronar për këtë banesë është njohur personi i tretë.

13. Pretendimi i paditësit se personi i tretë duhej të kundërshtonte vendimi nr. 45, datë 30.05.1994, të K.K.K.Pr. nuk qëndron, pasi personi i tretë e ka fituar pronësinë mbi banesën 60 m² edhe mbi bazën e një vendimi gjyqësor, që e ka shqyrtuar këtë çështje në themel për këtë pronë, objekt gjykimi.

14. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me Vendim nr. 619, datë 18.12.2012, ka vendosur: « Lënien në fuqi të vendimit nr. 2548/1232 datë 05.10.2012, të Gjykatës së Rrethit Sarandë ».

15. Kundër vendimit Nr. 619, datë 18.12.2012, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër kanë paraqitur rekurs paditësat P.Q dhe F.Q. dhe kërkuar prishjen e të dy vendimeve të mësipërme dhe pranimin e padisë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Ne, paditësat kemi kundërshtuar këtë titull ekzekutiv vetëm për sipërfaqen 60 m² dhe banesën mbi të, duke kërkuar pavlefshmërinë e titullit për këtë pjesë. Shkaku ligjor i këtij kërkimi është fakti, që në vendim të organit kompetent (K.K.K.Pr.) pronë na është njohur dhe na është kthyer ne si pronarë të saj.
- K.K.K.Pr. na i ka kthyer ne këtë pronë me vendimin nr. 45, datë 30.05.1994, dhe këto të drejta pronësie i kemi regjistruar në Z.R.P.P.
- Në këto rrethana, i njëjti K.K.K.Pr., i cili ka disponuar me vendimin Nr. 175, datë 19.05.1995, nuk është shprehur për sipërfaqën 60 m², duke thënë se kjo sipërfaqe toke është e zënë me ndërtime. Personi i tretë këtë vendim të K.K.K.Pr. pikërisht për sipërfaqen 60 m² e ka kundërshtuar në gjykatë dhe Gjykata e Rrethit Delvinë e ka ndryshuar këtë vendim të K.K.K.Pr. (nr. 175...) duke vendosur kthimin e sipërfaqes prej 60 m² tokë personit të tretë.
- Për rrjedhojë V.K.K.Pr. Nr. 175, datë 19.05.1995, i ndryshuar me vendimin Nr. 325, datë 14.06.1996, të Gjykatës së Rrethit Delvinë është absolutisht i pavlefshëm, pasi ka disponuar të drejtën e pronësisë të një prone, e cila në momentin e këtij disponimi të dytë s'ka qënë në pronësi të shtetit, por në pronësi të paditësave.
- Përderisa V.K.K.Pr. Delvinë Nr. 45, datë 30.05.1994, nuk është kundërshtuar nga askush, pra është ligjërish në fuqi dhe përbën titull ekzekutiv dhe është detyruar edhe për K.K.K.Pr. që e ka marrë (vendosur) atë.
- Ne si pronarë me titull të ligjshëm e të vlefshëm pronësie nuk kemi qënë palë në gjykimin e çështjes, në të cilën Gjykata e Rrethit Delvinë, me vendimin Nr. 325, datë 14.06.1996, ka ndryshuar vendimin e dytë të K.K.K.Pr. Nr. 175, datë 19.05.1995, due vendosur kthimin e sipërfaqes prej 60 m² personit të tretë. Pra, kuptohet që në këtë gjykim ne s'kemi qënë palë e për rrjedhojë vendimi i dhënë nuk parashikon asnjë detyrim për ne. Në këtë kuptim ky vendim nuk përbën titull ekzekutiv për ne.

Pvetjet:

Duke patur parasysh faktet dhe rrethanat e mësipërme, para jush shtrohen këto pyetje:

1. **A përbën titull ekzekutiv për paditësat F.Q, Vendimi Nr. 325, datë 14.06.1996, i Gjykatës, i cili ka marrë formë të prerë, por paditësja F.Q s'ka qënë palë? (5 pikë)**



